

S T A T U T
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“PUKA WIND SOLAR FARM” SH.P.K.

Sot ne date 20/01/2023 shoqeria “CONSTAL” SH.P.K , me seli ne Tirane, Rr”E Kavajes” ne cilesine e Ortakut te vetem te Shoqerise “PUKA WIND SOLAR FARM ” Sh.p.k, perfaqesuar nga Ortaku I Vetem I Shoqerise Z.Paolo Rubin,atesia Luigi, lindur ne Cavarzere (VE) me 01/08/1969 , mbajtes i dokumentit me numer identifikimi YB4932789 , ne cilesine e Ortakut te vetem te Shoqerise “CONSTAL ” Sh.p.k, ka redaktuar dhe nenshkruar Statutin e Ri te Shoqerise “PUKA WIND SOLAR FARM ” sh.p.k. regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit, ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14 Prill 2008 “Per Shoqerite Tregtare ne Republiken e Shqiperise”, Ligjit 9723, date 03.05.2007 dhe te akteve te tjera ligjore.

KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHESHME
Neni 1

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar, “PUKA WIND SOLAR FARM ” sh.p.k, eshte person juridik i pavarur, ka te drejta dhe detyrime per te cilat pergjigjet brenda kufijve te percaktuar ne Ligjin Nr. 9901, date 14 Prill 2008, Ligjit 9723, date 03.05.2007 si dhe akteve te tjera ligjore.

Neni 2

Shoqeria e ushtron veprimtarine e saj private ne baze te ekonomise se tregut te lire.

Neni 3

Themeluesi i shoqerise ne kete siper marrje ka derdhur kapitalin e tij me qellim qe te perfitoje te ardhurat qe mund te vijne nga veprimtaria private si dhe te perballoje humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit ne kapitalin fillestar.

Neni 4

Shoqeria “PUKA WIND SOLAR FARM ” SHPK, eshte person juridik dhe fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe me paisjen me dokumentin perkates nga organi kompetent.

EMRI, QENDRA, TERITORI
Neni 5

Emertimi i Shoqerise do te jete :Shoqeria Private me Pergjegjesi te Kufizuar - “PUKA WIND SOLAR FARM ” SH.P.K
Selia e Shoqerise do te jete ne adresen : Tirane, Rr” E Kavajes”, Njesia bashkiake 7, Pallati 132/4, kati 2.



Neni 6

Shoqeria mund te zhvilloje aktivitetin e saj ne te gjithë teritorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

O B J E K T I

Neni 7

Shoqeria ka kete objekt veprimtarie :

Ndertimi dhe projektimi i impianteve te energjise elektrike nga burimet e rinovueshme, projekte dhe turbine me ere, ndertime civile e industrial, projektim dhe instalim te strukturave te posacme. Ndertimi i punimeve civile dhe elektromekanike. Shitja, shperndarja, transmetimi dhe prodhimi i energjise elektrike. Cdo aktivitet ekonomik, tregtar, financiar qe gjykohet i nevojshem per realizimin e qellimit te korporates, duke perfshire shitjen e asetëve te kompanise si makinerite, paisje, dhenie me qira dhe leasing. Projektim, ndertim, dhe mirmbajtje te centraleve gjeneruese per prodhimin e energjise elektrike nga burime te rinovueshme si dielli ose era. Realizim te impianteve fotovoltaike dhe eolike per gjenerimin e energjise elektrike.

AFATI I VEPRIMTARISE

Neni 8

Aktiviteti privat i shoqërisë do te zhvillohet me nje afat te pacaktuar, mbi 10 vjet.

Neni 9

Shoqeria eshte e detyruar te mos e ndryshoje destinacionin e saj. Ndryshimi i destinacionit te veprimtarise ekonomike financiare, mund te behet me lejen e organeve perkatese.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 10

Kapitali themeltar i Shoqërisë "PUKA WIND SOLAR FARM" SH.P.K, perbehet nga kontributi i themeluesit te shoqërisë ne vleften prej 100.000 leke i ndare ne 1 kuote dhe shoqëria "cONSTAL" sh.p.k, zoteron 1 (nje) kuote dhe 100% te kapitalit themeltar . Kapitali mund te rritet me zhvillimin e veprimtarise ekonomike financiare te shoqërisë.

Neni 11

Transferimet e kapitalit themeltar, duhet te vertetohen me akt – noterial. Shoqëria apo te tretet, duhet te respektojne keto transferime sapo ti behen te ditura asaj.

Neni 12

Pjeset e kapitalit themeltar jane te transferueshme ne rruge trashegimie. Ato mund tu kalojne bashkeshorteve, paraardhesve dhe pasardhesve.

Neni 13

Pjese te kapitalit mund ti transferohen edhe personave te trete, qe nuk bejne pjese ne shoqëri, me pelqimin dhe vendimin e ortakut te shoqërisë dhe ne rast te shtimit te numrit te ortakëve me vendimin e asamblese se ortakëve.



DREJTIMI ADMINISTRATIV

Neni 14

Shoqeria **“PUKA WIND SOLAR FARM ” SH.P.K** do te kete si Administrator per nje periudhe 5-vjeçare **Z.Paolo Rubin**, atesia Luigi , lindur ne Cavarzere (VE) me date 01/08/1969 dhe banues ne Tirane , mbajtes i dokumentit pasaporte me nr. YB4932789 .

Ortaku i shoqerise ka kopetence te caktojne si administrator edhe persona te tjere te cilet nuk kane cilesine e ortakut, me nje afat prej 5 (pese) vjetesh.

Neni 16

Administratori ka per detyre organizimin dhe drejtimin e shoqerise. Ai mund te kryeje te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise.

Neni 17

Ne maredhenie me te tretet administratori angazhon shoqerine nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj. Ne rastet kur administratori eshte i emeruar nga themeluesi i shoqerise, kryen te gjitha veprimet e administratorit te shoqerise, me perjashtim te atyre qe jane ne kopetencen e themeluesve te shoqerise.

Neni 18

Asambleja e ortakut te shoqerise ka kopetence :

- . Te miratoje programin e shoqerise, te hartoje raportin e administrimit, inventaret, llogarite vjetore, te cilat hartohen brenda nje afati 6-mujor, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar.
- . Vendos per shperberjen e shoqerise.
- . Vendos per ndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve.
- . Rregullon maredheniet e punesimit e te shperblimit brenda shoqerise.
- . Sipas akteve ligjore shlyen detyrimet ndaj organeve shteterore, personave juridike e fizike, vendas a te huaj.
- . E te tjera.

Neni 19

Ne rast se administrimi i shoqerise kryhet nga nje administrator i zgjedhur posaçerisht nga ortaku themelues, ky i fundit miraton aktet e administrimit brenda afateve te mesiperme dhe kane te drejte te informohen per veprimtarine e shoqerise si dhe te njihen me llogarite dhe dokumentet e shoqerise.

Neni 20

Administratori humbet detyren e ngarkuar ne rast te prishjes se shoqerise ose kur shkarkohet nga ortaku i shoqerise. Ne rastin e fundit, shkarkimi i administratorit behet ne baze te nje akti me shkrim te ortakut te shoqerise. Ne rast se shkarkimi behet pa te drejte, ai le shkak per demshperblim financiar.

K R E U II

MAREDHENIET EKONOMIKO- FINANCIARE

Neni 21



Shoqeria "PUKA WIND SOLAR FARM" SH.P.K, mund te lidhe kontrata me sektoret shteterore, drejtperdrejt me tregun e lire si dhe me persona juridike e fizike, vendas a te huaj, sipas legjislacionit ne fuqi.

Neni 22

Ne veprimet kontraktuale, shoqeria perfaqesohet prej administratorit ose nga persona te tjere te autorizuar prej tij.

Neni 23

Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per shoqerine dhe punonjesit e saj.

Neni 24

Sipas rregullave te caktuara nga Ministria e Financave dhe akteve te tjera ligjore, shoqeria pergjigjet per kontributin fiskal, afatet e derdhjes se tij, detyrimet ndaj shtetit, sigurimet shoqerore, etj. Sipas ligjit te tatimit mbi fitimin, percaktohen tatimet per veprimtarine tregetare te shoqerise. Shoqeria ka te drejte te çele llogari likuiduese prane bankave te vendit, te huaja ne Shqiperi dhe te kryeje veprimet e likuidimit nepermjet tyre.

Neni 25

Per sigurimin e veprimeve ekonomike, shoqeria ka te drejte te vetefinancohet ne leke ose valute te huaj.

Neni 26

Shkembimin e monedhes shqiptare me monedhe te huaj e anasjelltas, mund ta beje ne perputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shtetit Shqiptar ose me tregun e lire privat te valutes.

Neni 27

Te ardhurat nga veprimtaria private do te sigurohen sipas çmimeve qe i cakton vete shoqeria. Çmimet dhe tarifat do te caktohen sipas kerkeses dhe ofertes.

Neni 28

Shoqeria ka te drejte te transferoje jashte shtetit kapitalin dhe pjesen e saj te fitimit ne valute. Per pjesen e fitimit qe transferohet jashte, shoqeria paguan nje tatim te percaktuar ne dispozitat perkatese te legjislacionit shqiptar.

Neni 29

Per pasqyrimin e aktivitetit tregtar, Administratori ose persona te tjere te caktuar nga ortaku, jane te detyruar te mbajne dokumentacion te rregullt financiar dhe regjistrat perkates sipas ligjit te veçante.

Neni 30

Veprimtaria ekonomike e shoqerise, mbaron ne muajin Dhjetor te çdo viti. Administratori eshte i detyruar te paraqese bilance periodike, bilance vjetore se bashku me deklaraten e fitimeve dhe humbjeve dhe ti depozitoje ato ne organin financiar te juridiksionit perkates ku ushtron aktivitetin shoqeria.

KREU III MAREDHENIET E PUNESIMIT

Neni 31



Themeluesi I shoqerise vendos per shtimin ose pakesimin e numrit te ortakeve dhe personave te tjere qe do te punesohen ne veprimtarine e shoqerise "PUKA WIND SOLAR FARM" SH.P.K

Neni 32

Maredheniet e punesimit brenda shoqerise regullohen sipas kontrates qe lidhet lirisht midis paleve. Kontrata leshohet nga administratori dhe ortaket e shoqerise.

Neni 33

Marrja ne pune nga punedhenesi behet me regjistrimin e punonjesve ne librin e punes se shoqerise, si dhe duke njoftuar organet e punes se juridiksionit ku e ushtron aktivitetin shoqeria.

Neni 34

Punonjesit e shoqerise, jane te detyruar te respektojne disiplinën e punes dhe mbajne pergjegjesi per thyerjen e saj.

Neni 35

Ndaj personave qe demtojne pronen e shoqerise, zbatohen masa ndeshkimore, te cilat percaktohen nga themeluesit e shoqerise dhe ne mungese te tyre zbatohen dispozitat e Kodit te Punes te Republikës se Shqipërisë.

Neni 36

Kontrata e punes mund te lidhet me ose pa afat te caktuar, sipas kriterëve te caktuara nga ortaku i shoqerise dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar (Kodin e Punes).

Neni 37

Punonjesit e gezojne lejen vjetore dhe lejen plotesuese sipas kriterëve te percaktuara ne kontraten e punes dhe ne mungese te tyre, sipas Kodit te Punes te Republikës se Shqipërisë.

Neni 38

Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punes behet ne baze te nje akti te leshuar me shkrim nga Ortaku dhe Administratori i Shoqerise. Largimi lidhet me mbarimin e kontrates se punes, per shkak te shkeljeve disiplinore ose me vete kerkesen e te interesuarit.

Neni 39

Punonjesi qe largohet ose transferohet ne nje pune tjeter, duhet te dorezoje detyren ne baze te nje akti me shkrim, pasi te kete likuiduar detyrimet materiale dhe monetare. Akti i mesipermbahet nga administratori i shoqerise.

ELEMENTE TE TJERA

Neni 40

Per zhvillimin dhe zgjerimin e veprimtarise, shoqeria mund te marre truall per ndertim, me qira ose ne pronesi, si dhe objekte te ndertuara sipas nje kontrate te vecante.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

Neni 41



Te ardhurat neto pas shlyerjes se detyrimeve fiskale, sigurimet shoqerore, etj. kalojne ne pronesi te ortakut te shoqerise.

Neni 42

Shperblimi per administratorin dhe personat e punesuar ne veprimtarine e shoqerise "PUKA WIND SOLAR FARM" SH.P.K Tirane, caktohen sipas kontrates se punes. Ndryshimi ne page vendoset nga themeluesi i shoqerise.

Neni 43

Shoqeria perballon humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit fillestar ne kapitalin baze.

Neni 44

Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilit i jane zbritur ose shtuar numrat respektive te humbjeve apo fitimeve te mbartura nga vitet e meparshme.

Neni 45

Kur pushon aktiviteti i shoqerise, kapitali i mbetur, pasi shlyhen te gjitha detyrimet, i kalon ortakut te shoqerise.

Neni 46

Fitimi i mbetur kalon ne pronesi te ortakeve pasi jane shlyer te gjitha detyrimet tatimore si dhe pagesat e mundeshme per punonjesit e shoqerise.

SHPERBERJA E SHOQERISE

Neni 47

Ne rast se kapitalet e shoqerise per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentet financiare, rezultojne me te vogla se gjysma e kapitalit themeltar, ortaku themelues, vendos brenda 4 (kater) muajve nga dita e konstatimit, mbi mundesine e prishjes se parakoheshme te shoqerise dhe mund te kerkoje prishjen e saj.

Neni 48

Ne rast se shoqeria nuk prishet, detyrohet te zvogelojne kapitalin e saj ne nje vlere jo me te vogel se ajo e humbjeve qe ka mbetur pa mbuluar, por do te kene parasysh qe shuma e kapitalit te mbetur te jete mbi 100.000 leke.

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 49

Themeluesi, ne rastin e shtimit te numrit te ortakeve, ka te drejten te beje ndryshimet e nevojshme ne statut si dhe te hartoje dhe kontraten e perbashket me ortaket e tjere, duke bere ndryshimet e nevojshme ne Qendren Kombetare te Biznesit ne Tirane.

Neni 50

Mosmareveshjet e shoqerise ne maredhenie me persona juridike e fizike, vendas a te huaj, zgjidhen me mirkuptim, ne te kunderten, kur kjo nuk arrihet, zgjidhen ne Gjykatën Rrethit Gjyqesor perkates.

Neni 51



Persa nuk eshte shprehur ne kete Statut, i referohet Ligjit Nr. 9901, Date 14 Prill 2008 “Per Shoqerite Tregtare ne Republikën e Shqiperise” , Ligjit 9723 date 03.05.2007 per Qendren Kombetare te Biznesit si dhe çdo akti tjeter te legjislacionit shqiptar.

Neni 52

Statuti perpilohet ne kater kopje per t’ju dorezuar organeve kopetente. Nje kopje e tij mbetet si pjese perberese e dokumentacionit te formimit te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar “**PUKA WIND SOLAR FARM ” SH.P.K**

THEMELUESI I SHOQERISE

“PUKA WIND SOLAR FARM ” SH.P.K

Perfaqesuar nga ortaku

SHOQERIA ”CONSTAL” SH.P.K

ORTAKU I VETEM I SHOQRISE

Paolo Rubin



A handwritten signature in blue ink, appearing to be "Paolo Rubin", written over the logo.